

VENDIM
Nr. 179, datë 23.8.2021

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL SHA, NË CILËSINË E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN KORRIK 2021

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimet e Bordit nr. 144, datë 25.6.2018, dhe nr. 233, datë 20.12.2019; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.8.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 113/5 prot., datë 20.8.2021, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin korrik 2021”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” (FSHU sh.a.), me shkresën e saj nr. 7272 prot., datë 11.8.2021, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për muajin korrik 2021, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Bazuar në kërkesën e FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, për vitin 2021, janë vlerësuar sa ato të vitit 2020.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit: bazuar në vendimin nr. 212, datë 15.12.2020, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021”, është 0.75 lekë/kwh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV: bazuar në vendimin nr. 213, datë 15.12.2020, të Bordit të ERE-s, “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE-s nr. 199, datë 12.12.2019, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes, sipas nivelit të tensionit, për vitin 2021”, është 1.5 lekë/kwh.

- Sasia e energjisë elektrike e prokuruar vetëm në treg të parregulluar është 1,488 mwh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përlllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin korrik 2021, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

<i>Çmimi i FMF-së për muajin korrik 2021</i>				
Korrik 2021		Aplikimi FSHU Përlllogaritjet e		
			sh.a.	ERE-s
		Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	lekë/kwh	10.974	10.974
Pr	<u>Kthimi për riskun, i përcaktuar në përqindje, për vitin (3%)</u>	<u>lekë/kwh</u>	<u>0.19</u>	<u>0.33</u>
	Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante	lekë/kwh	6.44	11.30
CA	Kostoja administrative e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	lekë/kwh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	lekë/kwh	0.75	0.75
TSh	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	lekë/kwh	1.50	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+		lekë	15.	15.

- Për sa përcaktohet, për çdo element të formulës përlllogaritëse, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë aplikim, informacionet e procedurës së blerjes së energjisë nga shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë”, si dhe vlerësimeve të ERE-s, sa më sipër, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike, të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin korrik 2021, të jetë 15.34 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga FSHU sh.a., në cilësinë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, prej 15.34 lekë/kwh, për muajin korrik 2021.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti